

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Kur u njoha me të, ishte në burg", rrëfimi i bashkëshortes së Jakup Krasniqit pas dënimit në Hagë: E prisnim në shtëpi, kishim bërë plane - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/kur-u-njoha-me-te-ishte-ne-burg-rrrefimi-i-bashkeshortes-se-jakup-krasniqit-pas-denimit-ne-hage-e-prisnim-ne-shtepi-kishim-bere-plane/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 17:23:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:47:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b9e7832e105be89651fffe0bbe04374821d21407c00328e9f2c3cc94ea8d33b4
TEKSTI	b860e87b5ed23aca44bc38c7ea2c47d46aa0a5b10e6832b038e755237f7263ca
PAMJA	71f5a1f9811087f83e45c8a94200026450e769819a23bba430f2885065a2d8b9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	003622aa0f3dc9d60bd54989bb387d7dea7ffff4c6e92324abc1467a43f37c55
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	a0e62f20f1566f1a6ab80e6e4e50c1c4744bc54a84695e6ceb27bc326e386c4d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/003622aa0f3dc9d60bd54989bb387d7dea7ffff4c6e92324abc1467a43f37c55

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » "Kur u njoha me të, ishte në burg", rrëfimi i bashkëshortes së Jakup Krasniqit pas dënimit në Hagë: E prisnim në shtëpi, kishim bërë plane

KOSOVË

Demo

"Kur u njoha me të, ishte në burg", rrëfimi i bashkëshortes së Jakup Krasniqit pas dënimit në Hagë: E prisnim në shtëpi, kishim bërë plane

SEPTEMBER 17, 2026



Pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, bashkëshortja e Jakup Krasniqit, Sevdije Krasniqi, ka rrëfyer përjetimet e familjes pas dënimit, duke thënë se deri në momentin e fundit kishin shpresuar për një vendim pafajësie.

Në një intervistë për gazetaren e Top Channel, Kristi Gongo, ajo tha se vendimin e kishte ndjekur nga shtëpia dhe se rezultati ishte i papritur për familjen.

"Ne kishim shpresë se do të shpallejshin të gjithë të pafajshëm. Vendimin e kemi pritur në shtëpi. Momenti i vendimit ishte shokues, nuk e prisnim. Kush janë ata 4 persona që po dënohen? Ata janë krerët e UÇK-së. Historia nuk do të helmohet nga asnjë vendim. UÇK-ja ka luftuar për liri. Ky vendim as nuk ndikon dhe as nuk duhet të ndikojë në jetën e Kosovës", tha Sevdije Krasniqi.

Ajo u shpreh se familja do të presë procesin e Apelit dhe kërkon ndryshimin e vendimit dhe lirin e të dënuarve.

"Ne kërkojmë lirin e tyre, do të presim Apelin. Besoj se tani do të bazohen në fakte. Tani dihet që ndërmarrja e përbashkët kriminale është udhëheqja e Serbisë bashkë me gjyqtarët e Gjykatës Speciale që dhanë këtë vendim", u shpreh ajo.

Gjatë intervistës, Sevdije Krasniqi foli edhe për marrëdhënien e saj me Jakup Krasniqin dhe mënyrën se si ishte njohur me të. Ajo tregoi se në atë kohë ai ndodhej në burg.

"Ma propozoi një shoqe e ime dhe më tha: 'Ia vlen ta presësh profesor Jakupin'. Unë e prita dhe, pasi doli, ne u bëmë bashkë. I kam thënë Jakupit që nuk të kam ardhur në burg atëherë, por në Hagë do të të vij çdo muaj...", tregoi ajo.

Për bashkëshorten e ish-krerit të UÇK-së, një nga momentet më të vështira ka qenë mungesa e tij në ngjarjet e rëndësishme familjare gjatë viteve që ai ka qëndruar në Hagë.

"E kam përjetuar shumë rëndë kur kemi pasur gëzime në shtëpi, që ai nuk ka mundur t'i përjetojë", tha Sevdije Krasniqi.

Ajo rrëfeu gjithashtu se familja kishte pritur kthimin e tij në shtëpi dhe se së bashku kishin bërë plane për jetën pas përfundimit të procesit gjyqësor.

"Ne e prisnim në shtëpi, kishim bërë plane. Madje, me Jakupin kishim thënë që do të iknim të dy të jetonim në një shtëpi në fshat", pohoi ajo.

Duke folur për qëndrimin e bashkëshortit të saj ndaj procesit gjyqësor, Sevdije Krasniqi tha se ai kishte shprehur dyshime për mënyrën se si po zhvillohej çështja, duke iu referuar edhe arrestimit të tij.

Postimet e reja

"JO NË EMRIN TIM!",
Taulant Xhaka reagon pa...

SEPTEMBER 17, 2026

"Kur u njoha me të, ishte
në burg", rrëfimi i...

SEPTEMBER 17, 2026

Thaçi apelon vendimin e
Hagës: Mohoj çdo...

SEPTEMBER 17, 2026

Kontrollet me pajisje
inteligjente në Fier, mbi...

SEPTEMBER 17, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

**Kompania e krijuar tri ditë pas
hapjes së thirrjes për grantet e
startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në
fazën e rezervuar për biznese të
paktën 1-vjeçare**

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant
2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

**Skema sesi IUTE zbras
fitimin nga Shqipëria, që
ju merr konsumatorëve
me interesa mbi 30%!**

**Skandal me sallamin në
dyqanet Conad, thirrje
konsumatorëve ta kthejnë
mbrapsht**

**6 milionë euro të Startup
Albania: Përfutuesit, qokat
dhe "problematikët"**

Na ndiq

Facebook

Instagram

“Duke parë si rrodhën gjërat, tha: ‘Nuk besoj shumë, sepse është gjykatë raciste’, nga mënyra si na kanë arrestuar, kur vetë ai ka mundur të dorëzohet. Pra, një arrestim si në kohën e ish-Jugosllavisë, madje edhe më rëndë”, deklaroi ajo.

Pas vendimit të shkallës së parë, familja e Krasniqit thotë se shpresat tashmë janë te procesi i Apelit dhe kërkon që të përdoren të gjitha rrugët ligjore.

“Ne kërkojmë që të përdoren të gjitha mjetet ligjore për zhbërjen e kësaj gjykate. Ne po shpresojmë në Apel. Kjo gjykatë nuk duhet të ketë më të drejtë të merret me luftëtarët tanë. Ne kemi përballuar gjenocid”, u shpreh Sevdije Krasniqi.

Në fund të rrëfimit, ajo përcolli edhe mesazhin e saj për bashkëshortin në këtë periudhë të vështirë.

“Unë Jakupit i them të qëndrojë i fortë, ashtu siç ai është”, tha ajo.

jakup krasniqi

SHARE.

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu